



PLANI LOKAL I RINISË 2024-2027 BASHKIA LUSHNJE

PËR TË RINJTË,
ME TË RINJTË!





Financuar nga Bashkimi Europian



Plani Lokal i Rinisë 2024-2027 i Bashkisë Lushnje u përgatit nga Bashkia Lushnje dhe Qendra “Strehëza Edlira Haxhiymeri” në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Europian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e Bashkisë Lushnje dhe Qendres “Strehëza Edlira Haxhiymeri” dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian (BE) ose Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Fjala përshëndetëse nga Kryetarja e Bashkisë

Të dashur të reja, të rinj dhe qytetarë të Bashkisë Lushnje!

Në rrugëtimin tonë drejt një të ardhmeje të qëndrueshme dhe gjithmonë e më shumë gjithëpërfshirëse kemi ndërmarrë një nisëm, të cilën e konsiderojmë me rëndësi për të ardhmen e Bashkisë sonë, sikurse hartimi i Planit Lokal të Rinisë, plan që synon të ketë në fokus të veçantë kategorinë më vitale të popullsisë sonë.

Rinia është e sotmja dhe e ardhmja e afërt e jona, ndaj zërat, aspiratat dhe shqetësimet tuaja janë dhe duhet të vazhdojnë të jenë në krye të vendimarrjes sonë. Plani Lokal i Rinisë është një dëshmi e përkushtimit dhe detyrimit tonë publik për të dëgjuar dhe për të reflektuar çdo këshillë, rekomandim apo nevojë që vjen nga ju, si vajza dhe djem të bashkisë sonë. Është padiskutim edhe një plan që synon të nxisë gjithnjë e më shumë interesin e të rinjve dhe të rejave për t'u përfshirë në vendimarrjen lokale qoftë përmes zërave individual apo edhe klubeve e organizatave rinore.

Plani Lokal i Rinisë 2024- 2027 vjen si një detyrim i plotësuar i Bashkisë Lushnje për të kuptuar nevojat, aspiratat dhe dëshirat unike të rinisë për të ndërtuar një të ardhme sa më të sigurtë, në qytetin tonë, me mundësi të konsiderueshme dhe të barabarta për të gjithë, pavarësisht hapësirës gjeografike ku jetojnë.

Qëllimi i Planit Lokal të Rinisë 2024-2027 është krijimi i një mjedisi mbështetës dhe fuqizues që mundëson zhvillimin e të rinjve dhe të rejave, duke përfshirë nxitjen e mirëqenies së tyre fizike dhe mendore, ofrimin e mundësive për forcimin e aftësive profesionale dhe mirëedukimi e tyre, promovimin e angazhimit qytetar dhe krijimin e hapësirave sa më miqësore për të rinjtë.

Suksesi i planit të Rinisë do të kërkojë angazhimin, kontributin dhe partneritetin mes institucioneve shtetërore, rrjeteve dhe strukturave të përfaqësimit rinor, organizatave rinore dhe në mënyrë të veçantë do të kërkojë bashkëpunimin dhe angazhimin e vetë të rinjve, të cilët kanë edhe rolin kryesor.

Duke ju siguruar se tek institucioni i bashkisë do të gjeni gjithnjë një partner të besueshëm për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, ju falenderoj të gjithëve që u bashkuat me ne, në këtë përpjekje të rëndësishme dhe pres me padurim e besimplotë rezultatet e rëndësishme si fryt i kësaj përpjekjeje të përbashkët.

Miqësisht,

Eriselda Sefa,

Kryetare e Bashkisë Lushnje



PËRMBAJTJA

- 1 HYRJE
- 2 PËRSE TË KEMI NJË PLAN VEPRIMI PËR RININË?
- 3 KUSH JANË TË RINJTË?
- 4 BASHKËRENDIMI DHE NDËRLIDHJA E PLANIT LOKAL TË RINISË ME POLITIKAT DHE KUADRIN LIGJOR PËR TË RINJTË
- 5 TË RINJTË NË BASHKINË LUSHNJE
 - Vizioni
 - Qëllimi
- 6 POLITIKAT
 - Politika 1: Rritja e angazhimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve
 - Politika 2: Nxitja e edukimit dhe e punësimit të të rinjve
 - Politika 3: Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies
 - Politika 4: Promovimi i kulturës, artit, dhe mjedisit
- 7 METODOLOGJIA
- 8 ÇFARË THONË TË RINJTË?
- 9 PLANI I VEPRIMIT
- 10 MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR RININË 2024-2027





HYRJJE

Bashkia Lushnje ka zhvilluar një plan rinor gjithëpërfshirës për të fuqizuar dhe mbështetur të rinjtë në komunitet. Me një qëllim të qartë, objektiva strategjike, vizion dhe metodologji. Plani Lokal i Rinisë synon të krijojë një mjedis mundësues, gjithëpërfshirës dhe inkurajues për të rinjtë e Bashkisë Lushnje.

Qëllimi i Bashkisë Lushnje është që të krijojë një mjedis mbështetës dhe fuqizues që mundëson zhvillimin e të rinjve, duke i pajisur ata me aftësi dhe mjete të nevojshme për të qënë të suksesshëm dhe për të dhënë kontribute pozitive për komunitetin e përbashkët. Për ta arritur këtë, Plani Lokal i Rinisë 2024-2027 mbështetet në katër politika.

Së pari, ai synon të përmirësojë edukimin dhe punësimin e të rinjve, duke ofruar mundësi të edukimit formal dhe informal, programe për ndërtimin e aftësive dhe nxitjen e partneriteteve me institucionet arsimore dhe bizneset.

Së dyti, prioritet është promovimi i shëndetit dhe mirëqenies, duke zbatuar nisma që kanë prioritet mirëqenien fizike dhe mendore.

Së treti, plani synon të nxisi angazhimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve, duke i përfshirë në mënyrë aktive të rinjtë në proceset vendimmarrëse dhe duke ofruar mundësi për angazhim qytetar.

Së katërti, plani synon të fuqizojë të rinjtë duke ofruar mundësi për shprehje artistike, kulturore dhe angazhim mjedisor, duke nxitur rritjen e tyre personale, mirëqenien dhe pjesëmarrjen aktive në komunitet.

VIZIONI i Bashkisë Lushnje është të krijojë një komunitet gjithëpërfshirës ku të rinjtë fuqizohen, mbështeten dhe angazhohen në mënyrë aktive në formësimin e së ardhmes së tyre. Bashkia synon një mjedis edukues që promovon barazinë dhe kultivon qytetarinë e përgjegjshme mes të rinjve dhe vë theksin tek puna rinore cilësore dhe me standarte me të rinjtë.

Për të siguruar suksesin e Planit Rinor Lokal dhe një adresim sa më të mirë të nevojave është ndjekur një metodologji gjithëpërfshirëse ku janë zhvilluar fokus grupe me të rinjtë, intervista me palët e interesuara dhe një rishikim të kuadrit ligjor dhe të politikave në lidhje me të rinjtë. Kjo qasje siguron që plani të jetë i informuar, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me nismat ekzistuese.

Nëpërmjet Planit Lokal të Rinisë, Bashkia synon të krijojë një mjedis edukues që u mundëson të rinjve të ecin përpara, të rriten dhe të kontribuojnë në përmirësimin e komunitetit të përbashkët.

PËRSE TË KEMI NJË PLAN VEPRIMI PËR RININË?

Plani Lokal i Rinisë 2024-2027 i Bashkisë Lushnje ofron një platformë fuqizimi për të rinjtë, me të rinjtë dhe nga të rinjtë duke e bërë Bashkinë tonë një vend ku të rinjtë shpalosin potencialin e tyre dhe jetojnë në harmoni dhe prosperitet.

Bashkia Lushnje e ka konsideruar gjithmonë rininë si prioritet dhe fokus të veprimtarisë së saj, pjesë edhe e dokumentave të rëndësishëm strategjik si Strategjia e Zhvillimit të Teritorit, Plani i Përgjithshëm Vendor dhe Plani Social Vendor 2022-2025. Vetëm gjatë vitit 2022 Bashkia Lushnje aplikoi me një numër të konsiderueshëm projekt-propozimesh me fokus rininë, nga të cilat të gjitha u shpallën fituese.

Qëllimi i këtij plani është të shërbejë si një nga dokumentat më të rëndësishëm udhëzues në përmbushjen e detyrimeve dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për të gjithë të rinjtë në të gjithë territorin e bashkisë Lushnje me shtrirje në çdo njësi administrative, në qytet e zonat rurale, për t'i fuqizuar ata e për t'i dhënë krahë e jetë potencialit të tyre. Plani Lokal i Rinisë i kushton rëndësi të veçantë fuqizimit të të rinjve nëpërmjet edukimit jo-formal, nxitjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të punës cilësore me të rinjtë ashtu siç shprehet qartë në Axhendën Europiane të Punës me të rinjtë, Partnershipit strategjik Europe Goes Local.

KUSH JANË TË RINJTË?

Mosha e rinisë shpesh përshkruhet si një periudhë kalimtare gjatë të cilit ne përjetojmë ndryshime fizike, këmi emocione të ndryshme, por edhe mësohemi të jetojmë në dinamikat e zhvillimit të botës përtej nesh dhe aftësohemi të bashkëjetojmë edhe në komunitete të ndryshme (Schlozman. S., E. Beresin, 2008).

Por, përtej koncepteve të zhvillimit, kuadri ligjor dhe politik e shih konceptin për të rinjtë në një dimension më të gjerë. Shqipëria është një nga vendet europiane me një popullsi relativisht të re, ku 22.7% e popullsisë janë të moshës 15-29 vjeçare (INSTAT, 2021).

Përcaktimi i saktë i përkufizimit të moshës së rinisë ka qenë një temë diskutimi. Sekretariati i OKB-së përdor termat rini dhe të rinj për të nënkuptuar moshën 15-24 vjeçare, duke pranuar se vende të ndryshme mund të kenë përkufizimet e tyre specifike.



OKB-ja e përdor këtë përkufizim kryesisht për qëllime statistikore, veçanërisht në fusha si demografia, arsimi, punësimi dhe shëndetësia, mbi të cilat ndërtohen politikat e zhvillimit për të rinjtë. Ndërsa, Komisioni Europian i përkufizon të rinjtë si individë të moshave nga 15 deri në 29 vjeç.

Vlen të theksohet se grupmoshat e përdorura për të përcaktuar rininë ndryshojnë ndjeshëm midis vendeve të ndryshme; për shembull, Luksemburgu i përkufizon të rinjtë si ata të moshës nga 0 deri në 30 vjeç, ndërsa Irlanda përfshin vetëm ata midis 15 dhe 24 vjeç. Në Shqipëri, “të rinj” janë personat, i ri ose e re, që kanë mbushur moshën 15 vjeç deri në 29 vjeç. (Ligji Nr. 75/2019 “Për Rininë”).

Ligjërisht, nuk ka një emërtim specifik për këtë grupmoshë. Megjithatë, ekziston një konsensus i përgjithshëm midis institucioneve dhe organizatave që i konsiderojnë individët nga 15 deri në 29 vjeç si të rinj, në përputhje me grupmoshat e përdorura nga EUROSTAT dhe dokumentet politike të Bashkimit Europian (BE). Vlen të theksohet se grupmoshat e përdorura për të përcaktuar rininë ndryshojnë ndjeshëm midis vendeve të ndryshme; për shembull, Austria i përkufizon të rinjtë si ata të moshës nga 14 deri në 24 vjeç, ndërsa Irlanda përfshin vetëm ata midis 0 dhe 24 vjeç.

Secili shtet ka përkufizime të ndryshme për rininë për shkak të një sërë faktorësh që lidhen me normat kulturore, kuadrin ligjor, lëvizjet demografike, prioritetet ekonomike, kontekstin historik, dhe zhvillimin në tërësi. Këta faktorë formojnë përkufizimin e rinisë brenda secilit shtet duke marrë në konsideratë nevojat dhe rrethanat specifike të të rinjve dhe duke iu përmbytur karakteristikave unike të tyre.



BASHKËRENDIMI DHE NDËRLIDHJA E PLANIT LOKAL TË RINISË ME POLITIKAT DHE KUADRIN LIGJOR PËR TË RINJTË

Bashkimi European ofron mbështetje për të rinjtë përmes politikave dhe programeve fuqizuese. Portali European i Rinisë ofron informacion në nivel European dhe vendor për mundësitë dhe nismat që janë me interes për të rinjtë që jetojnë, mësojnë dhe punojnë në Europë. Strategjia e Bashkimit European për Rininë është korniza për bashkëpunimin e BE-së për politikat rinore për 2019-2027. Qëllimet e strategjisë janë të nxisë pjesëmarrjen e të rinjve duke mbështetur angazhimin social dhe qytetar. Synimi kryesor është të sigurohet që të gjithë të rinjtë të kenë burimet e nevojshme për të marrë pjesë në shoqëri. Në kuadër të këtyre nismave, Tirana u përzgjedh si Kryeqyteti European i Rinisë për vitin 2022. Gjatë gjithë vitit, u mundësuan nisma dhe evente rinore për pjesëmarrjen aktive të të rinjve nga të gjitha qytetet e Shqipërisë me synim promovimin e vullnetarizmit, fuqizimin e organizatave rinore dhe krijimin e rrjeteve dhe sinergjive mes të rinjve.

Kuadri ligjor dhe strategjik kanë për qëllim të mbrojnë të drejtat, mirëqenien dhe mundësitë e barabarta të të rinjve, duke garantuar për të rinjtë të drejtën për arsimim dhe punësim, aksesin në kujdesin shëndetësor dhe mirëqenien sociale, mbrojtjen nga shfrytëzimi dhe abuzimi, promovon pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e të rinjve në proceset demokratike, ruan lirinë e tyre të shprehjes dhe aksesin në informacion dhe mbron të drejtën e tyre për privatësi. Këto masa synojnë të sigurojnë mirëqenien, zhvillimin dhe të drejtat e të rinjve, duke nxitur një shoqëri që vlerëson dhe mbron të rinjtë e saj. Plani i Veprimit për të Rinjtë është hartuar duke patur në konsideratë kuadrin ligjor dhe strategjik si mëposhtë:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i kushton një rëndësi të veçantë për mbrojtjen e të rinjve sipas së cilës “Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti”. (Neni 54, pika 1). Theksimi i mbrojtjes së të rinjve në Kushtetutë pasqyron angazhimin e Shqipërisë për krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse që vlerëson mirëqenien dhe të drejtat e të gjithë qytetarëve të saj, pavarësisht nga mosha apo gjinia duke hedhur themelet për politikat, programet dhe nismat që synojnë të mbështesin dhe të fuqizojnë të rinjtë.

Ligji Nr. 75/2019 “Për Rininë”:

Ligji Nr. 75/2019 “Për Rininë” ka si qëllim përcaktimin e veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë, si dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti.

Gjithashtu, ky ligji parashikon që njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë një rol të rëndësishëm në formulimin dhe zbatimin e politikave rinore, respektimin e të drejtave të të rinjve, përcaktimin e objektivave dhe sigurimin e zbatimit efektiv të tyre. Përgjegjësitë e tyre përfshijnë krijimin e strukturave rinore në nivel lokal, koordinimin e aktiviteteve për mbrojtjen dhe fuqizimin e rinisë, ofrimin e mbështetjes dhe nismave për zhvillimin e të të rinjve, promovimin e vullnetarizmit dhe edukimit joformal, financimin e infrastrukturës rinore dhe hapësirave të sigurta, krijimin e strukturave administrative për çështjet rinore, shpërndarjen e fondeve buxhetore për programe rinore.

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029 është dokumenti ku bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve dhe synon hartimin e politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me artet dhe zëjet, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizëm, etj. Hartimi i Planit të Veprimit për të Rinjtë i Bashkisë Lushnje është i përafuar me parashikimet dhe planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 sipas politikave dhe objektivave strategjik të mëposhtëm, të cilat parashikojnë një rol aktiv të njësisë të qeverisjes vendore në fuqizimin e të rinjve:

Politika 1: “Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore”: Objektivi Specifik 1.1 Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike dhe Objektivi Specifik 1.2 Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomikisht aktive.

Politika 2: “Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity)”: Objektivi Specifik 2.1 Mbështet dhe nxit novacionin rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës dhe Objektivi Specifik 2.2 Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuar cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyeteve të tyre.

Politika 3: “Mirëqenia dhe Përfshirja”: Objektivi Specifik 3.1 Mbrojtja mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale dhe Objektivi Specifik 3.2 Të rejtat dhe të rinjtë mbështeten në përfshirjen dhe integrimin e tyre në shoqëri dhe kanë mundësi rekreative dhe kulturore, duke përfshirë artet dhe sportet.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026

Plani Lokal i Rinisë 2024-2027 ka integruar edhe veprimtaritë që lidhen me grup-moshën 15-19 vjeçare të parashikuara në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026. Kjo agjendë synon të krijojë një mjedis të favorshëm për mirëqenien e fëmijëve nëpërmjet aksesit në shërbime cilësore, praktikave pozitive të pjesëmarrjes, prindërimit të mirë, eliminimit të çdo forme dhune dhe të zhvillimit në botën digjitale. Kryesisht, Plani Lokal i Rinisë 2024-2027 është mbështetur në Politikën 3 “Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë” dhe në masa të veçanta të politikave të tjera, ku njësitë e qeverisjes vendore kanë një rol aktiv në garantimin e të drejtave të të rinjve dhe në fuqizimin e tyre.

“**Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025**”, e cila synon krijimin e mjedisit të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese në sektorin publik dhe privat duke bashkërenduar punën edhe me njësitë e qeverisjes vendore. Strategjia ka të parashikuar përmbushjen e Politikës 5 “Hartimi dhe zbatimi i një platforme arsimore përmes institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore dhe sistemit parauniversitar” dhe si objektivi specifik Edukimin Përmes Kulturës.

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026

Lidhur me edukimin cilësor dhe gjithëpërfshirës, Plani Lokal i Rinisë 2024-2027 është mbështetur në parimet dhe qëllimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021 – 2026. Kjo strategji synon ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve, nxënësve e studentëve, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt për diversitetin. Në hartimin e këtij plani veprimi është marrë në konsideratë roli dhe kontributi që Bashkia ka lidhur me përbushjen e Qëllimit Strategjik “Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimit gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin European”.

“Agjenda Digjitale e Shqipërisë” dhe e Planit të Veprimit 2022–2026 e cila nënvizon rëndësinë që qytetarët e të gjitha moshave të përgatiten për një shoqëri digjitale duke e arritur këtë nëpërmjet rritjes së integritimit të teknologjive inovative në proceset mësimore të arsimit fillor dhe të mesëm.

“Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030” theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të çënueshme dhe që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, azilkërkuese, etj., pra nga të gjitha grupet në shoqëri. Kjo strategji parashikon një sërë masash që duhen marrë në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore lidhur me edukimin për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore, aftësimin e të rejave në drejtim të biznesit, rëndësinë e pjesëmarrjes së vajzave e të rejave në shkencë, teknologji, inxhinieri e matematikë, gjithëpërfshirjen në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor, etj.

“Strategjia e Zhvillimit të Teritorit” (2016) përmban dimension strategjik dhe rregullator dhe vizionin vendor të zhvillimit territorial, mjedisor e social-ekonomik të Bashkisë Lushnje. Plani lokal i veprimit për të rinjtë është në përputhje me punën për hapjen dhe pasurimin e Qendrës Multifunkionale për të rinjtë e cila synon të aktivizojë grupet rinore dhe të nxisë krijimtarinë dhe bashkëpunimin midis tyre, si dhe të promovojë vlerat kulturore dhe rikthimin e jetës sociale dhe aktiviteteve në qendrat urbane.

“Plani Social Vendor” 2022-2025 i Bashkisë Lushnje ka përcaktuar objektivat dhe prioritetet strategjike tre vjecare 2022-2025, sigurojë dhe ofrojë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Plani Social i zonës përfaqëson një instrument thelbësor nëpërmjet të cilit Bashkia Lushnje, në bashkëpunim me të gjithë institucionet publike, individët, organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat, harton sistemin e integruar të ndërhyrjeve dhe të shërbimeve sociale. Ai është një instrument bazë për vlerësimin e nevojave, planifikimin e aktiviteteve, realizimin e monitorimin e vazhdueshëm të shërbimeve sociale, si dhe për hartimin e politikave lokale sociale dhe planifikimin e projekteve sociale.

Plani lokal i veprimit për të rinjtë është në linjë me objektivin 3 për nxitja e të rinjve të papunë për të marrë formim profesional për dhënie e bursave për të rinj nga familje të grupeve në nevojë për ndjekjen e arsimit të mesëm profesional ose të përgjithshëm në bashkëpunim me qendrat/shkollat e arsimit profesional dhe të përgjithshëm.

TË RINJTË

në Bashkinë Lushnje

Misioni kryesor i Bashkisë Lushnje është t'i shërbejë interesave të komunitetit, të garantojë sigurinë dhe mirëqenien sociale të qytetarëve, barazinë gjinore, të drejta të barabarta; respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individëve pavarësisht përkatësisë etnike, fetare, gjinisë, orientimit seksual, zonës gjeografike ku ata jetojnë dhe trajtojnë çdo aspekt tjetër në funksion të ofrimit të shërbimeve cilësore tek qytetarët.

Drejtoria e Promovimit, Integritit Europian dhe Rinisë

Drejtoria e Promovimit, Integritit Europian dhe Rinisë, në bashkinë Lushnje është një drejtori dedikuar rinisë, pjesë e strukturës së të cilës është edhe një punonjës për rininë, me emërimin "Specialist për Arsimin, Rininë, Vullnetarizmi".

Këshilli rinor vendor

Që prej vitit 2011 në Bashkinë Lushnje është krijuar Këshilli Rinor me të rinj që jetojnë në Bashkinë Lushnje, të cilët përveç aktiviteteve të ndryshme rinore që organizojnë kanë ndërmarrë, gjithashtu, edhe nisma të ndryshme vullnetare në komunitet, si: pastrimi i mjedisit, ndihma për njerëzit në nevojë, të moshuarit, të prekurit nga tërmeti, COVID, etj.

Kjo strukturë tashmë është konsoliduar në bazë të ligjit Nr. 75/2019 si Këshilli Rinor Vendor dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak, Bashkia Lushnje ka krijuar tashmë Këshillin Rinor Vendor më 20.04.2022 dhe në përbërjen tij janë 7 anëtarë (5 meshkuj dhe 2 femra) dhe ka zhvilluar 5 mbledhje. Në Bashkinë Lushnje ka, gjithashtu, edhe një grup me të rinj vullnetarë me të cilët janë ndërmarrë nisma të ndryshme në komunitet. Bashkëpunimi me të rinjtë ka qenë gjithmonë të përfrytëdhënës dhe të rinjtë kanë qenë bashkëpunëtorë në nisma të ndryshme komunitare dhe në takime konsultative në kuadër të projekt-propozimeve fituese nga Bashkia.

Në Bashkinë Lushnje ndodhen 47 institucione arsimore, të cilat janë:

2 Gjimnaze, 3 Shkolla të Mesme të Bashkuara, 12 shkolla 9-vjecare dhe 30 Cikël i Ulët.

Nxënës në shkollat e mesme: 2.578 në Gjimnaze: 80,7%, në Gjimnaze të orientuara (social-kulturore): 0 % dhe në shkolla Profesionale: 19,3 %.

Në institucionin e Bashkisë Lushnje janë të punësuar 51 të rinj në drejtori të ndryshme dhe në institucione vartëse, ku 35 janë femra dhe 16 janë meshkuj.

Qendra rinore multifunkionale

Qendra Rinore Multifunkionale Lushnje ofron shërbime për të rinjtë në mbështetje të fuqizimit të tyre. Përfituesit kryesor të të gjithë shërbimeve falas që do të ofrojë qendra, përfshijnë të rinjtë e Lushnjes dhe gjithë komunitetin në tërësi. Nëpërmjet aktiviteteve të Qendrës Rinore Multifunkionale të rinjtë fitojnë njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime që nevojiten për zhvillimin e tyre personal, integrimin social dhe qytetarinë aktive. Aktivitetet zhvillohen duke përdorur metodat e edukimit jo-formal dhe zbatojnë principet e punës rinore cilësore duke siguruar fuqizim, angazhim, kreativitet dhe gjithëpërfshirje.

Qendra Rinore Multifunkionale është ngritur falë projektit fitues të Bashkisë Lushnje titulluar: “Unleashing the Potential of Youth of Lushnja” (“Çliri potencialin e të rinjve të Lushnjes”), objektivi i përgjithshëm i të cilit është të kontribuojë në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të të rinjve të Lushnjes, duke përmirësuar infrastrukturën publike vendore, aksesin në shërbime dhe cilësinë e tyre.

Qendra Rinore Multifunkionale Lushnje ofron tri kurse falas për të rinjtë për përmirësimin e talenteve të tyre në pikturë, kërcim dhe muzikë; si dhe në katër klube rinore si më poshtë:

1. Kulturë dhe Art
2. Sport
3. Mjedis
4. Integrim

Klubet e krijuara organizojnë aktivitete, të cilat lidhen jo vetëm me fushat e sipërpërmendura, por sjellin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve për vlerat e BE-së, mbrojtjen e mjedisit dhe pjesëmarrjen aktive në aktivitetet kulturore dhe sportive.

Qendra ofron shërbimet e saj për të gjithë të rinjtë e Lushnjes në vazhdimësi duke ofruar kurse e shërbime cilësore falas. Këto shërbime do të zgjerohen edhe me ofrimin e shërbimit të këshillimit të karrierës, shërbim i cili do të ofrohet në qendër, falë një tjetër projekti fitues të Bashkisë Lushnje që është aktualisht në fazë fillestare por edhe një numër të larmishëm shërbimesh të tjera me tematika të ndryshme falë bashkëpunimeve dhe partneriteteve që bashkia Lushnje është duke ndërtuar.

“Pjesëmarrja aktive e të rinjve dhe numri i shtuar i kërkesave për t’u bërë pjesë e aktiviteteve tona dhe rikthimi i disa prej tyre çdo vit janë tregues të suksesit të punës sonë dhe kjo na bën të përpunueshëm e optimist për vazhdimësinë dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve në Qendrën Rinore”

Nga këto shërbime përfitojnë të gjithë të rinjtë e Bashkisë Lushnje, të grupmoshave të ndryshme bazuar ndër të tjerash edhe në LIGJIN Nr. 75/2019 “PËR RININË” por edhe më gjerë. Target grupi përfshin djemtë, vajzat, komunitetin Rom dhe Egjyptian, të rinjtë me aftësi të kufizuara, të rinjtë që jetojnë në zonat rurale, dhe çdo i ri/e re që ka dëshirë dhe shpreh interesin për t’u bërë pjesë e aktiviteteve dhe shërbimeve në qendër.

Në muajin shkurt-mars 2023, stafi i Bashkisë Lushnje realizoi takime me të rinjtë në të gjitha institucionet arsimore në qytetin e Lushnjes si dhe në Njësitë Administrative të saj, duke diskutuar mbi të gjitha projektet fituese të Bashkisë Lushnje me fokus rininë dhe ftesën për t’iu bashkuar aktiviteteve e shërbimeve për ta në Qendrën Rinore Multifunksionale.

Stafi i Njësisë së Integritit European përbëhet nga të rinj aktiv, të cilët janë krijues dhe gjithëpërfshirës për organizimin e aktiviteteve. Disa nga sfidat shoqërore që adresojmë në aktivitete përfshijnë:

- përjashtimin,
- diskriminim,
- stereotipet,
- izolimin social,
- sfidat sociale, etj.

Njësia e Integritit European është një departament i veçantë në Bashkinë Lushnje, pjesë e një drejtorie ku ka gjithashtu edhe specialistë dedikuar rinisë, që lidhet me organizimin e ngjarjeve lokale në ditët dhe javët Europiane si dhe organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme për grupe të ndryshme të synuara në lidhje me programet, mundësitë e BE-së, etj. Që nga themelimi i saj në vitin 2018, kjo njësi ka organizuar shumë aktivitete në ditë dhe javë të ndryshme Europiane.

Njësia e Integritit European mirëpret të gjithë të rinjtë me ide krijuese në përmirësim të aktiviteteve me praktikatat më të mira në lidhje me grupet dhe projekte të ndryshme të synuara ndaj dhe kjo njësi vazhdimisht punon në fushën e vullnetarizmit dhe shkëmbimeve rinore në kuadër të ESC apo Peace of Corps.

Disa tema që trajtohen gjatë aktiviteteve të Njësisë së Integritit European përfshijnë: Vlerat e BE-së, historiku i BE-së, institucionet e BE-së, programet dhe mundësitë për të rinjtë si dhe mjedis, art, kulturë, integritim, sport, apo tema me funksion ndërgjegjësimin si bullizmi, emigracioni i sigurt, mbrojtje mjedisi, vullnetarizëm, pjesëmarrje aktive, etj.

Nga këto shërbime përfitojnë të gjithë të rinjtë e Bashkisë Lushnje, të grupmoshave të ndryshme bazuar ndër të tjerash edhe në LIGJIN Nr. 75/2019 “PËR RININË” por edhe më gjerë. Target grupi përfshin djemtë, vajzat, komunitetin Rom dhe Egypcian, të rinjtë më aftësi të kufizuar, të rinjtë që jetojnë në zonat rurale, dhe çdo i ri/e re që ka dëshirë dhe shpreh interesin për tu bërë pjesë e aktiviteteve.



Këto praktika përfshijnë projektet dhe aktivitete që realizon Bashkia Lushnje dhe ndër të tjera edhe partneritetet, si:

- Europe for Citizens “Live Free in the Melting Pot”, (Aplikantë lider) me partner Comune di Cervicati Itali, Zëri Qytetar, (Lushnje, Shqipëri), Shoqata për zhvillim kulturor, sportiv dhe arsimor World of Change (Valandovo, Maqedoni) Ayuntamiento De Pego (Pego, Spanjë), Jugendtreff Déifferdang (Differdange, Luksemburg), Comune di Portopalo di Capo Passero (Portopalo di Capo Passero, Itali). Fokusi i projektit janë të rinjtë dhe të drejtat e tyre.

- Dream “Distance and Remote Education to Achieve More” me partner Oou “Nevena Georgieva-Dunja” (Maqedoni), Ege Ilkokulu (Ankara, Turqi), Uniwersytet Pedagogiczny Im Komisji Edukacji Narodowej Krakowie (Poloni), Cooperativa De Formacao E Animacao Cultural Crl (Portugali), Euphoria Net Srl (Itali), L.E.A.R.N Institute (Francë). Fokusi i këtij projekti janë të rinjtë si dhe lehtësimi i mësimin në distancë pas pandemisë Covid-19.

- INCLUDE Project, me partnerë Asociatia Babilon Travel, PVN Albania, Pro Bista Ministry SOAW.

Gjithashtu, në kuadër të projektit ReLOad - Programin Rajonal për Demokraci Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOad2) janë mbështetur financiarisht dy OSHC gjatë thirrjes së parë (KREO, CDCI) si dhe dy OSHC gjatë thirrjes së dytë: (Horizont EU, Qendra Strehëza) dhe dy OSHC për rininë (MIL, PVN) në kuadër të ngritjes së forumeve tematike rinore.



Aktivite të organizuara nga Bashkia Lushnje për të rinjtë

Bashkia Lushnje e ka konsideruar gjithmonë rininë si prioritet dhe fokus të veprimtarisë së saj, pjesë edhe e dokumentave të rëndësishëm strategjik si Strategjia e Zhvillimit të Teritorit, Plani i Përgjithshëm Vendor dhe Plani Social Vendor 2022-2025.

Aktivitetet që organizohen nga Bashkia Lushnje për të rinjtë janë të shumta duke përfshirë si aktivitete ndërgjegjësuese, edukuese, sensibilizuese, krijuese e artistike me tematika si aktivitete që realizohen përfshijnë një gamë të gjerë temash me në fokus të rinjtë. Larmishmëria e temave të caktuara përfshijnë: të drejtat e njeriut, dhuna, barazia gjinore, diskriminimi, trafikimi i qënieve njerëzore, shëndeti mendor etj.

Gjatë vitit 2022 Bashkia Lushnje aplikoi me një numër të konsiderueshëm projekt-propozimesh në programe dhe projekte me fokus rininë, nga të cilat të gjitha u shpallën fituese. Ndër to mund të përmendim:

- “Të rinjtë për të rinjtë” - Rikonstrukcioni dhe Rikompozimi i Bibliotekës së Qytetit, me mbështjen e Agjensisë Kombëtare të Rinisë (AKR);
- "Unleashing the Potential of Youth of Lushnja" (EU4Municipalities);
- European Solidarity Corps (ESC), Quality Label;
- "Ngritja e zyrave të shërbimit të këshillimit të karrierës në nivel vendor";
- Europe Goes Local.

Gjatë fazës së aplikimit të disa prej këtyre projekteve, pas publikimit të thirrjes, janë organizuar takime konsultative me të rinjtë e Këshillit Vendor Rinor, për të dëgjuar idetë e sjella në jetë dëshirat e tyre e për ta bërë vendimarrjen tonë me të përgjegjshme ndaj këtij target grupi.

Një praktikë e ndjekur gjatë fazës së aplikimeve ka qenë përfshirja e të rinjve në takime konsultuese pas publikimit të thirrjeve si faktor i rëndësishëm në suksesin e këtyre nismave.



BASHKIA LUSHNJE PËR TË RINJTË

Quality Label për programin European Solidarity Corps

Bashkia Lushnje është e vetmja bashki e akredituar me Quality Label për programin European Solidarity Corps (ESC), ku ka rolin e organizatës mbështetëse si dhe dërguese për të rinjtë e grupmoshës 18-30 vjeç. Gjatë vitit 2022 u bë pjesë e një takimi rrjetëzues me organizatat e Ballkanit Perëndimor. Në takimin vjetor rezidencial të organizatave ESC në Niš, Serbi ku do të krijohen partneritetet e para. Programi European Solidarity Corps (ESC) ofron një mundësi të shkëlqyer për të rinjtë për t'u angazhuar në punë vullnetare brenda dhe jashtë vendit. Programi ESC nxit të rinjtë të zhvillojnë ndjenjën e solidaritetit duke marrë pjesë në aktivitete vullnetare individuale ose në grup dhe influencën rritjen e kompetencave të të rinjve në fusha të ndryshme.

Shkolla Verore

Njësia e Integritimit Europian në Bashkinë Lushnje ofron trajnime për të rinjtë si dhe ka organizuar një numër të madh e të larmishëm aktivitetesh për ta. Një model suksesi ka qenë edhe Shkolla Verore e kthyer tashmë në traditë vit pas viti, ku gjatë vitit 2022 u përfshinë në aktivitete të rinj nga dy bashki të tjera: Divjakë dhe Rroskovec.

Klubet e leximit

Një tjetër model suksesi ka qenë edhe ngritja e klubeve të leximit që kanë nisur si aktivitete të vogla dhe janë shembulli sesi pjesëmarrja e të rinjve bën të mundur që këto aktivitete të marrin përmasa të mëdha vit pas viti e të shumëfishohen në numër duke patur pjesëmarrje edhe të të rinjve nga bashki të tjera.



BASHKIA LUSHNJE PËR TË RINJTË

Europe Goes Local

Bashkia Lushnje është përzgjedhur, gjithashtu, në thirrjen Europe Goes Local në kuadër të zhvillimit të strategjive për rininë. Në kuadër të kësaj platforme, Bashkia Lushnje u bë pjesë e një eventi rrjetëzues në Ljublanë për të shkëmbyer eksperiencat në fushën e rinisë dhe është duke vazhduar me hapat e tjerë të këtij procesi në funksion të përmirësimit të kapaciteteve dhe shërbimeve në punën me të rinjtë. Europe Goes Local është një projekt bashkëpunimi European për të zhvilluar dhe forcuar punën rinore lokale. Misioni i Europes Goes Local është të forcojë praktikën e komunitetit të punës së të rinjve në nivel lokal, në përputhje me Axhendën Europiane të Punës Rinore dhe nga perspektiva e bashkive dhe e aktorëve lokalë të punës për të rinjtë.

Programet e shkëmbimit

Shumë prej të rinjve kanë patur edhe mundësinë për t'u bërë pjesë e shkëmbimeve rinore ndërkombëtare Erasmus+. Është punuar, gjithashtu, mbi zhvillimin e vullnetarizmit tek të rinjtë nëpërmjet nxitjes së nismave të ndryshme vullnetare më fokus individët në nevojë dhe kushte të vështira ekonomike, individët me aftësi ndryshe, si dhe mbrojtjen e mjedisit. Dy vullnetare nga Franca i janë bashkuar aktiviteteve në Njësinë e Integritit European, një eksperiencë vullnetare ku Bashkia kishte rolin e organizatës mbështetëse për një periudhë 6 mujore.

PLANI LOKAL I RINISË 2024-2027

BASHKIA LUSHNJE

VIZIONI

Vizioni i Bashkisë Lushnje është të krijojë një komunitet të gjallë dhe gjithëpërfshirës ku të rinjtë fuqizohen, mbështeten dhe angazhohen në mënyrë aktive në formësimin e së ardhmes së tyre. Ne parashikojmë një vend ku çdo i ri ka akses në arsim cilësor, mundësi për ndërtimin e aftësive dhe burime për të shkëlqyer në rrugët e tyre të zgjedhura.

Gjithashtu, vizioni është të nxitet një kulturë mirëqenieje, ku shëndeti fizik dhe mendor i të rinjve është prioritet, duke u mundësuar atyre të lulëzojnë dhe të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Bashkia aspiron të kultivojë një shoqëri ku të rinjtë janë të përfshirë në mënyrë aktive në proceset vendimmarrëse, duke dhënë kontribute domethënëse në zhvillimin e komunitetit dhe duke përqaftuar rolin e tyre si qytetarë të përgjegjshëm.

QËLLIMI

Qëllimi i Planit Lokal të Rinisë 2024-2027 është krijimi i një mjedisi mbështetës dhe fuqizues që mundëson zhvillimin e të rininjve.

Kjo përfshin nxitjen e mirëqenies së tyre fizike dhe mendore, ofrimin e mundësive për ndërtimin e aftësive dhe edukimin, promovimin e angazhimit qytetar dhe krijimin e hapësirave miqësore për të rinjtë. Qëllimi është që të pajisen të rinjtë me mjetet, burimet dhe mbështetjen e nevojshme për të ecur përpara, për të patur sukses dhe për të dhënë kontribute pozitive për komunitetin e tyre.



POLITIKAT

Politikat janë hartuar për të krijuar një mjedis mbështetës dhe fuqizues për të rinjtë, duke mundësuar zhvillimin e tyre dhe promovimin e pjesëmarrjes së tyre aktive në komunitet.

Politikat janë hartuar për të krijuar një mjedis mbështetës dhe fuqizues për të rinjtë, duke mundësuar zhvillimin dhe promovimin e pjesëmarrjes së tyre aktive në komunitet. Për këtë arsye, tek Plani i Veprimit, theks i veçantë është vendosur mbi edukimin joformal dhe metodat kreative të punës me të rinjtë që përqendrohen në aftësimin dhe zhvillimin personal dhe social, duke u ofruar atyre një platformë për të eksploruar, mësuar dhe zhvilluar aftësitë e tyre në një mjedis jo-tradicional. Kjo përfshin punën nëpërmjet klubeve rinore, projekteve të ndryshme dhe programeve që stimulojnë pjesëmarrjen, mirëqenien, krijimtarinë dhe iniciativën e të rinjve. Mbi këtë bazë, politikat do të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e punës me të rinjtë në komunitete, duke garantuar një standart të lartë të cilësisë dhe profesionalizmit. Të rinjtë do të përfitojnë nga një mbështetje e konsoliduar dhe puna me ta do të jetë e orientuar drejt rezultateve, duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin e tyre dhe në komunitetin e gjerë.

POLITIKA 1

**RRITJA E ANGAZHIMIT DHE
PJESËMARRJES SË TË RINJVE**

POLITIKA 2

**NXITJA E EDUKIMIT DHE E
PUNËSIMIT TË TË RINJVE**

POLITIKA 3

**PROMOVIMI I SHËNDETIT
DHE MIRËQËNIES**

POLITIKA 4

**PROMOVIMI I KULTURËS,
ARTIT, DHE MJEDISIT**

POLITIKA 1

RRITJA E ANGAZHIMIT DHE PJESËMARRJES SË TË RINJVE

Politika 1 synon përfshirjen aktive të të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe nxitjen e angazhimit të tyre qytetar, duke përfshirë nisma të tilla si fuqizimi i Këshillit Rinor Vendor dhe ofrimi i mundësive për vullnetarizëm dhe shërbim në komunitet. Qëllimi është që të fuqizohen të rinjtë që të kenë një zë, të kontribuojnë në komunitetin e tyre dhe të formojnë politika dhe nisma që i prekin drejtpërdrejt ata.

POLITIKA 2

NXITJA E EDUKIMIT DHE E PUNËSIMIT TË TË RINJVE

Politika 2 ka si qëllim ofrimin e mundësive edukuese dhe programeve të fuqizimit të aftësive për të nxitur edukimin dhe punësimin e të rinjve, duke përfshirë nisma të tilla si trajnimi profesional, programet e sipërmarrjes, këshillimi për karrierë dhe partneritete me institucionet arsimore dhe bizneset për të siguruar që të rinjtë të kenë aftësitë dhe mundësitë e nevojshme për punësim të qëndrueshëm.

Objektivat:

- 1.1 Fuqizimi i Këshillit Rinor Vendor si një platformë gjithëpërfshirëse për të rinjtë që të marrin pjesë në mënyrë aktive në proceset vendimmarrëse, të ndajnë perspektivat e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin e politikave dhe nismave të komunitetit.
- 1.2 Nxitja e nismave për të rinjtë dhe të udhëhequra nga të rinjtë për të marrë drejtimin në hartimin dhe zbatimin e nismave për çështjet që prekin drejtpërdrejt ata dhe bashkëmoshatarët e tyre.
- 1.3 Ofrimi i mundësive për angazhim në komunitet për të inkurajuar të rinjtë që të angazhohen në mënyrë aktive me komunitetet e tyre, të kontribuojnë me aftësitë dhe talentet e tyre dhe të nxisin ndjenjën e përgjegjësisë ndaj zhvillimit të komunitetit.

Objektivat:

- 2.1 Rritja e aksesit në arsim duke zbatuar nismat për të përmirësuar aksesin në arsimin cilësor për të rinjtë, duke përfshirë reduktimin e barrierave për regjistrimin në institucionet arsimore, ofrimin e bursave ose ndihmës financiare dhe zgjerimin e infrastrukturës arsimore.
- 2.2 Rritja e mundësive të formimit profesional duke zhvilluar dhe promovuar programe të trajnimit profesional që përputhen me nevojat e tregut të punës, duke u ofruar të rinjve aftësi dhe kualifikime që rrisin punësimin e tyre.
- 2.3 Nxitja e sipërmarrjes dhe inovacionit nëpërmjet krijimit të programeve dhe burimeve që mbështesin sipërmarrjen dhe inovacionin e të rinjve, duke ofruar mentorim, trajnime për zhvillimin e biznesit dhe akses në financim për të inkurajuar të rinjtë të fillojnë sipërmarrjet e tyre dhe të kontribuojnë në rritjen ekonomike.

POLITIKA 3

PROMOVIMI I SHËNDETIT DHE MIRËQËNIES

Politika 3 synon t'i japë përparësi mirëqënies fizike dhe mendore të të rinjve. Ajo përfshin zbatimin e nismave të tilla si organizimi i turneve sportive, seminareve të edukimit shëndetësor, shërbimeve mbështetëse të shëndetit mendor dhe promovimi i stileve të jetesës së shëndetshme. Qëllimi është të sigurohet që të rinjtë të kenë akses në burime dhe mbështetje që kontribuojnë në mirëqenien e tyre të përgjithshme.

Objektivat:

-
- 3.1 Nxitja e pjesëmarrjes sportive nëpërmjet zhvillimit të programeve dhe nismave si organizimi i turneve sportive dhe aktiviteteve recreative për të promovuar stile jetese të shëndetshme.

 - 3.2 Rritja e edukimit për shëndetin nëpërmjet seminareve dhe fushata të edukimit shëndetësor që mbulojnë tema të tilla si të ushqyerit, shëndeti seksual, parandalimi i abuzimit me substancat dhe ndërgjegjësimi për shëndetin mendor.

 - 3.3 Forcimi i mbështetjes për dhunën me bazë gjinore dhe bullizmin tek të rinjtë nëpërmjet krijimit të shërbimeve të aksesueshme duke përfshirë shërbimet e këshillimit, linjat e ndihmës dhe të referimit dhe fushatat ndërgjegjësuere.

POLITIKA 4

PROMOVIMI I KULTURËS, ARTIT, DHE MJEDISIT

Politika 4 synon të fuqizojë të rinjtë duke ofruar mundësi për shprehje artistike, kulturore dhe angazhim mjedisor, duke nxitur rritjen e tyre personale, mirëqenien dhe pjesëmarrjen aktive në komunitet.

Objektivat:

-
- 4.1 Rritja e aksesit dhe e angazhimit në veprimtaritë kulturore dhe artistike.

 - 4.2 Zgjerimi dhe diversifikimi i programeve dhe ngjarjeve kulturore dhe artistike të aksesueshme për të rinjtë.

 - 4.3 Bashkëpunim me artistë vendas, organizata kulturore dhe institucione për të ofruar aktivitete dhe ekspozita për të rinjtë

METODOLOGJIA

Qasja me të rinjtë në qendër. Për të angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të rinjtë në hartimin e planit lokal për rininë u organizuan fokus grupe, duke siguruar që nevojat dhe aspiratat e tyre janë në krye të strategjisë. Kontributi i tyre ka ndihmuar në formimin e nismave dhe programeve rinore që adresojnë sfidat dhe interesat e tyre specifike.

Bashkëpunimi me palët e interesuara. Intervistat me palët e interesuara ofruan një mundësi për të marrë sugjerime nga institucionet kryesore dhe organizatat dhe që luajnë një rol jetik në zhvillimin e të rinjve. Perspektivat dhe ekspertiza e tyre do të kontribuojë në efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e planit lokal për rininë duke nxitur partneritetin për të zbatimin e planit dhe duke shfrytëzuar burimet ekzistuese.

Rishikimi i kuadrit ligjor dhe i politikave për të rinjtë dhe përafrimi i politikave me Planin Lokal të Rinisë 2023-2027. Rishikimi i kornizës ligjore dhe i politikave ka ofruar një bazë për Planin Lokal të Rinisë, duke siguruar që ajo të jetë në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet ekzistuese.

Metodologjia e përdorur ka synuar të promovojë pjesëmarrjen e palëve të interesit dhe të përfituesve duke mundësuar që Plani Lokal i Rinisë 2024-2027 të jetë gjithëpërfshirës dhe të reflektojë perspektivat dhe aspiratat e të rinjve.



ÇFARË THONË TË RINJTË?

“Çështja kryesore që shqetëson të gjithë të rinjtë sot mendoj se është punësimi.”

“Mua më pëlqen shumë të bëj punëdore, ma ka mësuar gjyshja. Dhe në kohën time të lirë, e praktikoj.”

Të rinjtë mendojnë se krijimi i hapësirave të gjelbra dhe aktiviteteve në to do të rriste mundësinë e ndërveprimit me njëri-tjetrin.

Vëmendje për të rinjtë në zonat rurale për veprimtari rinore.

Panaire për të promovuar punimet dhe kulturën tradicionale

Pjesëmarrja e të rinjve gjatë formulimit të politikave rinore.

Kënde sportive pranë vendbanimeve.

Programe të shkëmbimit

Buxhet i posaçëm për veprimtari rinore.

Kinema verore ose shfaqje kulturore

Të rinjtë morën pjesë në konsultime dhe ndanë vizionin dhe sugjerimet e tyre për nismat dhe programet rinore. Në fokus grupe morën pjesë 78 të rinj, nga të cilët 47 vajza dhe 31 djem midis moshës 18 dhe 30 vjeç. Të nënvizojnë rëndësinë e adresimit të shqetësimeve të punësimit, krijimit të hapësirave të gjelbra dhe aktiviteteve për ndërveprim, përfshirjen e të rinjve në zonat rurale, promovimin e zanateve dhe kulturës tradicionale, përfshirjen e të rinjve në politikëbërje, krijimin e një jete të sigurtë dhe të shëndetshme dhe zhvillimin e programeve të shkëmbimit.

Me qëllim për të kuptuar nevojat dhe aspiratat e ndryshme të të rinjve nga grupmosha dhe me prejardhje të ndryshme, pjesëmarrja e tyre në diskutimin me fokus grupet na dha informacione të vlefshme lidhur me shqetësimet, dëshirat dhe sugjerimet e tyre për planin e veprimit për të rinjtë. Një nga çështjet kryesore që doli nga diskutimet e tyre ishte rëndësia e punësimit. Pothuajse përgjatë të gjitha diskutimeve, punësimi u identifikua si një shqetësim kryesor për të rinjtë.

Punësimi dhe puna është me rëndësi për të rinjtë, pasi shumë prej tyre u shprehën se ata ndihen më mirë duke qenë produktiv dhe të angazhuar. Një pjesëmarrëse u shpreh se : "Më pëlqen shumë të bëj punëdore, ma ka mësuar gjyshja. Dhe në kohën time të lirë, e praktikoj." Të rinjtë u shprehën se nxitja dhe krijimi i mundësive për punësim dhe aktivitete për aftësimin për punë mund të nxisë një ndjenjë përbushjeje tek të rinjtë

Krijimi i hapësirave të gjelbra dhe aktiviteteve në këto zona ishte gjithashtu një sugjerim kryesor nga diskutime gjatë fokus grupeve. Pjesëmarrësit sugjeruan se nisma të tilla jo vetëm që do të përmirësonin cilësinë e jetës, por do të rrisnin edhe mundësinë e ndërveprimit midis të rinjve. Duke ofruar hapësira të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë për t'u mbledhur dhe për t'u përfshirë në aktivitete të ndryshme, ata e shohin si mundësi për të krijuar marrëdhënie shoqërore dhe ndjenjë e përkatësisë në komunitet. "Krijimi i hapësirave të gjelbra dhe aktiviteteve në to do të rriste mundësinë e ndërveprimit me të rinjtë dhe me komunitetin".

Fokus grupet theksuan rëndësinë e përfshirjes dhe mundësive të barabarta për të rinjtë që jetojnë në zonat rurale. Ata u shprehën se duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje ofrimit të aktiviteteve dhe mundësive rinore në këto rajone. Kapërcimi i ndarjes urbane nga ajo rurale duke ofruar aktivitete rikrijuese dhe të zhvillimit të aftësive u konsiderua nga të rinjtë si vendimtare për mirëqenien e përgjithshme të të rinjve në këto zona.

Duke njohur rëndësinë e ruajtjes së artizanatit dhe kulturës tradicionale, të rinjtë theksuan nevojën për panairë e veprimtari që promovojnë aspekte të trashëgimisë së tyre. Me krijimin e platformave për të shfaqur e festuar traditat e tyre, të rinjtë mund të ndjejnë një lidhje më të fortë me rrënjët dhe identitetin e tyre.

Përfshirja aktive në formulimin e politikave rinore ishte një tjetër temë kryesore që u diskutua midis të rinjve. Ata shprehën dëshirën për të patur zërin e tyre në vendimet që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre. Të rinjtë mendojnë që duke përfshirë perspektivat e tyre dhe duke i angazhuar në procesin e politikëbërjes, autoritetet vendore mund të sigurojnë që planet e propozuara të jenë praktike dhe t'u përgjigjen nevojave të të rinjve.

Për të nxitur një kulturë të shëndetit dhe mirëqenies, të rinjtë theksuan rëndësinë e objekteve sportive pranë vendbanimeve. Duke pasur kënde sportive ose hapësira rekreative të aksesueshme, të rinjtë mund të angazhohen në aktivitete fizike, duke promovuar një mënyrë jetese më të shëndetshme.

Të rinjtë gjithashtu sugjeruan për zhvillimin e programeve të shkëmbimit që do t'u mundësonin të rinjve të ndërveprojnë me bashkëmoshatarë nga rajone dhe kultura të ndryshme. Këto programe mund të zgjerojnë horizontet e tyre, të nxisin shkëmbimin kulturor dhe të nxisin gjithëpërfshirjen. Nisma të tilla u panë si thelbësore nga të rinjtë që lidhen me rritjen e tyre personale dhe zhvillimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse.

Një aspekt tjetër që të rinjtë theksuan ishte krijimi i një buxheti të veçantë për aktivitetet rinore. Pjesëmarrësit shprehën dëshirën për programe dhe nisma që lidhen me nevojat dhe interesat e tyre. Duke elaboruar nevojën për një buxhet të posaçëm, të rinjtë theksuan si thelbësore nisma të drejtuara nga të rinjtë, si punëtoritë, ngjarjet sportive dhe artistike dhe nisma për angazhimin e komunitetit. Gjithashtu, të rinjtë theksuan se ata duhet të jenë pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes në lidhje me hartimin e buxhetit për të rinjtë pasi në këtë mënyrë ata ndihen se janë pjesë e zhvillimit të komunitetit dhe qytetit të tyre.

Një nga temat e spikatura që doli nga fokus grupet ishte organizimi i aktiviteteve kulturore dhe rikrijuese. Një sugjerim i përbashkët mes pjesëmarrësve ishte kinemaja verore. Për të rinjtë, këto veprimtari sjellin jo vetëm argëtim por edhe angazhim social për të rinjtë. Duke ofruar akses në veprimtari kulturore dhe shfaqjet kulturore në mjedise publike, ata u shprehën se jo vetëm njihen me bashkëmoshatarë të tjerë, por edhe arrijnë të kalojnë më shumë kohë cilësore në qytetin e tyre.

PLANI I VEPRIMIT

Objektivat	Aktivitetet	Treguesit	Periudha kohore e zbatimit	Buxheti	Institucionet zbatuese dhe palët e përfshira
RITJIA E ANGAZHIMIT DHE PJESËMARRJES SË TË RINJVE					
